



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Korrik, 2018

SBASHK në një takim të rëndësishëm me Ministrin Bytyqi

Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim



Delegacioni i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj është takuar me ministrin Shyqiri Bytyqi për të debatuar për situatën aktuale në arsim.

Në këtë takim fillimisht është biseduar për shqetësimin e ngritur nga mësimmshënësit lidhur me paralajmërimet se do të nis së zbatuari Udhëzimi Administrativ 06/2015, që ka të bëjë me normativin për kualifikimet në arsimin e mesëm të lartë. ... (faqe 4)

SBASHK-u takim me Koordinatorin për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri.



Punëtorët e arsimit duhet të kenë vend meritore në Ligjin e pagave

Me qëllim që të jenë të informuara nga dora e parë dhe saktë Qeveria dhe ... (faqe 5)

Interesim i madh për trajnimet e organizuara nga SBASHK

Në Kamenicë u punua me 5 grupe për dialogun social ... (faqe 4)



Intervistë me këshilltarin për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri

Na bëjnë krenar e të lumtur fjalët plot respekt të pushuesve.

Ymer Ymeri është menaxher për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm në SBASHK. Ai ... (faqe 3)

Edhe një marrëveshje në shërbim të anëtarësisë

Një numër i madh i shërbimeve shëndetësore në "Klinika Amerikan" me zbritje 10%



SBASHK-u, krahas mbrojtjes së fuqishme të kërkesave dhe të drejtave të anëtarësisë ... (faqe 6)



Editorlal

Edhe një vit i ri shkollor po vjen



Pushimet po ikin dhe neve na pret edhe një betejë për dije e njohuri të reja me nxënësit tonë kudo nëpër shkollat e Kosovës. Do të vazhdojmë me punë e përkushtim edhe në aspektin sindikal. Me unitet nëpër shkolla e njësi akademike do të vazhdojmë të angazhohemi për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe bashkërisht edhe do ia dalim.

Jemi të sigurt se pas angazhimeve të SBASHK dhe pas diskutimit të stërzgatur publik Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip për vitet e 90-ta do të shkojë prapë të deputetët dhe do të votohet.

Deputetët do ta votojnë, jo për arsye të presioneve sindikale, po për hir të respektit që ata kanë për njerëzit e viteve të 90-ta dhe për punën e tyre e angazhimin sublim në mbrojtjen e arsimit shqip nga furtunat e pushtuesit.

Po ashtu jemi duke përcjellë me kujdes edhe veprimet e institucioneve lidhur me Ligjin e pagave. Ne jemi takuar me Ministrat Bytyçi e Jagciallar dhe ua kemi rikujtuar vërejtjet tona të arsyeshme lidhur me ligjin e pagave. Ua kemi dorëzuar edhe propozimin tonë të argumentuar. Jemi të sigurt se institucionet do t'i analizojnë me kujdes faktet dhe do të përfilllet versioni i SBASHK-ut dhe kështu sistemi arsimor do të ketë vend meritore në Ligjin për pagat.

Do të kemi edhe sfida të tjera, por unik e me angazhime të përbashkëta do t'i kalojmë ato duke shënuar arritje të reja sindikale, por edhe suksese edhe më të mëdha në përkushtimin për arsim edhe më të mirë.

Na priftë e mbara bashkë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotet në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

Përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me këshilltarin për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri



Na bëjnë krenar e të lumtur fjalët plot respekt të pushuesve

Ymer Ymeri është menaxher për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm në SBASHK. Ai, krahas shumë detyrave që ia kërkon vendi i punës, vazhdimisht është në krye të

shumë aktiviteteve në shërbim të anëtarësisë. I përkushtuar ishte edhe në përgatitjen e pushimeve për anëtarët e SBASHK-ut nga e tërë Kosova. Në intervistën për gazetën tonë Ymeri u përgjigj me kënaqësi në pyetjet që pikërisht kanë të bëjnë me këtë traditë të mirë të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Vazhdimisht jeni në ballë të shumë aktiviteteve e angazhimeve të SBASHK-ut. Ishit përgjegjës edhe për organizimin e pushimeve të 435 anëtarëve të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar. Cilat janë përshtypjet tuaja pas këtij aktiviteti ?

Ymeri:

Kryesia e SBASHK-ut edhe këtë vit më emëroi kryetar të Komisionit për organizimin dhe mirëvajtjen e pushimeve të kolegëve tanë nga e tërë Kosova. Nuk është i lehtë ky aktivitet sepse kërkon angazhim të gjatë dhe përkushtim sepse pushimet duhet të organizohen mirë në mënyrë që pushuesit të kthehen me përshtypje sa më të mira nga bregdeti shqiptar. Këto pushime janë vlerësuar si të organizuara fort mirë dhe për këtë falënderoj pushuesit për qëndrimin e tyre dinjitoz. Falënderoj shumë edhe anëtarët e Komisionit Blendor Shatri, Afërdita Ahmeti, Nezafete Jakupi, Rrezarta Bahtijari, Shqipe Kastrati, Marigonë Bytyqi, Bajram Shala, Halime Ramën, Bahrie Islajlin dhe Sefedin Berishën, që më ndihmuan shumë për mirëvajtjen e pushimeve.

Arsimimi sot:

Çka i dallon pushimet e këtij viti nga ata të viteve tjera?

Ymeri:

Këtë vit duhej angazhim e përkushtim i shtuar sepse pushimet nuk mund të organizoheshin në të njëjtën kohë me të 435 pushuesit për arsye të kapaciteteve në Kompleksin Turistik “Bonita”, por u organizuan në tri grupe. Kjo ka bërë që në këtë aktivitet të jemi të përfshirë për një kohë më të gjatë. Por, falë përkushtimit të anëtarëve të Komisionit dhe qëndrimit dinjitoz të pushuesve çdo gjë kaloi në një atmosferë vërtetë të bukur dhe shumë nga pushuesit mirënjohjen dhe përshtypjet e tyre për pushimin dhe angazhimin tonë i kanë lënë të shënuara në fletoret e përshtypjeve.

Arsimimi sot:

Kush janë pushuesit në këtë aktivitet të qëlluar të SBASHK-ut ?

Ymeri:

Këshilli Drejtues bazuar në shumën e mbledhur në fondin për pushim dhe rekreacion cakton numrin e përgjithshëm të pushuesve dhe autorizon Kuvendet e SAF e SAM dhe atë të Universiteteve që të caktojnë në bazë të kriterëve shkollat, gjegjësisht njësitë akademike që do të dërgojnë pushues. Shoqatat sindikale që e kanë radhën për të dërguar pushues në takimet e tyre vendosin se kush nga shkollat e tyre apo njësitë akademike do të shkojë në pushime dhe emrat e tyre i dërgojnë te ne në SBASHK. Pra, pushuesit caktohen në takimet që i mbajnë kolegët tanë nëpër shkollat apo njësitë e tyre akademike.

Arsimimi sot:


Bazuar në përshtypjet e pushuesve që janë shënuar edhe në fletoret e përshtypjeve ky aktivitet ka qenë shumë i qëlluar. A do të vazhdohet me këtë traditë të mirë?

Ymeri:

Besoj po. Kjo traditë është e mirë dhe krahas pushimit, pjesëmarrësit po zhvillojnë edhe debate e takime duke shtruar pyetje nga më të ndryshmet e që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe angazhimet sindikale. Po zhvillohet një debat i shëndosh dhe pushuesit po marrin përgjigje konkrete për pyetjet e shtruar. Po ashtu në këto takime po lindin edhe ide për aktivitete sindikale në të ardhmen. Kolegët tanë kudo në Kosovë e meritojnë, pas punës së përkushtuar në arsimimin dhe edukimin e brezave, një pushim të tillë të organizuar mirë.

Intervista

SBASHK në një takim të rëndësishëm me Ministrin Bytyqi **Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim**



Delegacioni i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj është takuar me ministrin Shyqiri Bytyqi për të debatuar për situatën aktuale në arsim.

Në këtë takim fillimisht është biseduar për shqetësimin e ngritur nga mësimdhënësit lidhur me paralajmërimet se do të nis së zbatuari Udhëzimi Administrativ 06/2015, që ka të bëjë me normativin për kualifikimet në arsimin e mesëm të lartë.

Ministri Shyqiri Bytyqi i ka thënë përfaqësuesve të SBASHK-ut se është formuar një komision dhe se është duke punuar për ta nxjerrë një Udhëzim të ri lidhur me këtë çështje dhe se nuk ka vend për

Shqetësime sepse çdo gjë do të rregullohet me udhëzimin e ri.

Në këtë takim SBASHK-u edhe një herë ka ngritur pakënaqësitë dhe kundërshtimet lidhur me Ligjin e pagave duke rikujtuar se është i papranueshëm vendi në radhitjen që i është bërë punëtorëve të arsimit në tabelorin e këtij Ligji. SBASHK-u ka kërkuar që ministri Bytyqi dhe kabineti i tij të angazhohen me ngulm që kërkesat e argumentuara të SBASHK-ut të përfillen nga Ministria e Administratës Publike në mënyrë që punëtorët e arsimit të kenë vend meritore në këtë radhitje.

Kryetari i SBASHK-ut i ka kujtuar edhe një herë ministrin Bytyqi se nëse kjo çështje nuk përfilllet dhe nuk vepron për përmirësimin e lëshimeve në Ligjin për pagat, atëherë SBASHK-u do të veprojë duke respektuar zërin e punëtorëve të arsimit dhe se viti i ri shkollor do ta gjejë në grevë të përgjithshme tërë sistemin arsimor të Kosovës.

Ministri Bytyqi është shprehur i përkushtuar që kjo çështje të debatohet drejt në mënyrë që punëtorët e arsimit të kenë vend meritore në tabelën e gradimeve të Ligjit të pagave.

Interesim i madh për trajnimet e organizuara nga SBASHK **Në Kamenicë u punua me 5 grupe për dialogun social**



Një numër i madh punëtorësh arsimor nga Kamenica i janë drejtuar kryetarit të SAF e SAM të kësaj komune, Nazim Jakupi me kërkesën që SBASHK të organizojë trajnimin për forcimin e kapaciteteve sindikale për dialogun social. Këtë kërkesë kryetari Jakupi e ka drejtuar në SBASHK

duke marrë përgjigje pozitive dhe tërë mbështetjen e mundur.

Për të zhvilluar këtë aktivitet në Kamenicë janë gjendur edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe me juristin Blendor Shatri. Duke parë se interesimi është shumë i madh e për të krijuar kushte të duhura për punë, fillimisht është bërë ndarja e të interesuarve në 5 grupe dhe është arritur

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

pajtueshmëri edhe për orarin e zhvillimit të këtij aktiviteti të rëndësishëm. Për të pasur trajnimi rrjedhë të mbarë SBASHK-u, përveç trajnerëve aktual, ka angazhuar edhe znj. Besa Hoxha Krasniqi, Lutfi Manin dhe Blerim Mehmetin.

Ky interesim kaq i madh për këtë aktivitet të qëlluar të SBASHK-ut i ka bërë përshtypje të madhe edhe drejtoreshës së DKA-së, së Kamenicës znj. Ismete Thaqi, e cila ka bashkëbiseduar me mësimdhënësit e

kësaj komune dhe me kryetarin e SBASHK-ut z. Rrahman Jasharaj e koordinatorin z.Ymer Ymeri. Ajo ka lavdëruar SBASHK-un për angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe për këtë aktivitet shumë të qëlluar.

Ky aktivitetet ka vazhduar edhe në ditët e vikendit dhe ka pasur rrjedhë të mbarë.

Pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve në pjesën përmbyllëse të aktivitetit kanë treguar njohuri të mjaftueshme u pajisen me certifikata të nënshkruar nga përgjegjësit e MASHT dhe SBASHK.



SBASHK-u takim me Koordinatorin për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri.

Punëtorët e arsimit duhet të kenë vend meritor në Ligjin e pagave



Me qëllim që të jenë të informuara nga dora e parë dhe saktë Qeveria dhe institucionet tjera të shtetit lidhur me kundërshtimin e bazuar të SBASHK-ut përkitazi me radhitjen degraduese dhe vlerësimin jo meritor të sektorit të arsimit në tabelën e Projektligjit

SBASHK-ut, që tregojnë se sektori i arsimit meriton radhitje tjetër dhe meritore të arrijnë në adresat e duhura, një delegacion i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj është takuar me Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri.

Ky delegacion ka përcjellë te z. Tahiri zërin e punëtorëve të tërë sistemit arsimor të Kosovës se nëse nuk përfillen faktet dhe argumentet e SBASHK-ut lidhure me këtë çështje tepër të ndjeshme, atëherë shtatori në Arsimin Parauniversitar dhe tetori në Universitete do të nisin me greva të përgjithshme.

Edhe një marrëveshje në shërbim të anëtarësisë

Një numër i madh i shërbimeve shëndetësore në “Klinika Amerikan” me zbritje 10%

SBASHK-u, krahas mbrojtjes së fuqishme të kërkesave dhe të drejtave të anëtarësisë përballë institucioneve lokale e qendrore, krahas takimeve e trajnimeve të suksesshme, vazhdon me aktivitetet në shumë fronte për të qenë në shërbim të anëtarësisë.

Një aktivitet i rëndësishëm është edhe vizita nëpër institucione private shëndetësore dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me to për zbritje çmimesh për shërbimet mjekësore që ato ofrojnë.



Një marrëveshje e tillë është nënshkruar se fundi edhe me Klinikën Amerikane, e që është njëra nga 130 marrëveshjet e nënshkruara deri tani, Nënshkrimi i marrëveshjes mes të dy palëve është bërë në ambientet e këtij institucioni nga përfaqësuesi i "Klinikës Amerikane", Vullnet Kusari, ndërsa në emër të

Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri ka dëgjuar me vëmendje shqetësimet e SBASHK-ut dhe ka marrë nga delegacioni i kësaj sindikate gjithë argumentet e ofruara duke premtuar gjithë këto do t'i analizojë me vëmendje dhe se do ta njoftojë Kryeministrin Haradinaj dhe Qeverinë për çështjet e ngritura. Ai i ka deklaruar SBASHK-ut se duhen hequr dilemat se dikujt e në cilin do sektor a vend pune do t'i ulet paga, por si shtoi ai, ligji po përgatitet që të zgjidhet një herë e mirë e përmes ligjit çështja e pagave.

SBASHK-ut, kryetari Rrahman Jasharaj. I pari i këtij institucioni të njohur shëndetësor, z. Kusari është shprehur i lumtur që sot po nënshkruan këtë marrëveshje duke shprehur kështu respektin për gjithë personelin arsimor të Kosovës dhe për punën që ata janë duke bërë në edukimin dhe arsimimin e brezave.

“Institucioni Shëndetësor do t'i mundësojë anëtarëve të SBASHK-ut shërbime cilësore dhe përkujdesje maksimale në shërbimet që ofron Institucioni.

Institucioni Shëndetësor do të ofrojë 10% zbritje për të gjitha shërbimet e Institucionit, përveç shërbimeve të procedurës së IVF”, ka kujtuar dr. Kusari, i cili ka shtuar se përfituesit e shërbimeve me zbritje do të jenë anëtarët e SBASHK-ut dhe familja e ngushtë e tyre si: anëtari i sindikatës, gruaja e anëtarit, fëmijët e anëtarit, nëna dhe babai i anëtarit të sindikatës.

Pasi ka nënshkruar këtë marrëveshje për zbritje çmimesh për shërbimet në këtë institucion për anëtarësinë, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka shprehur mirënjohje për z. Kusarin dhe stafin e tij, që me këtë veprim human po shprehin respekt për të punësuarit në arsim dhe për misionin e tyre të shenjtë në edukimin e arsimimin e brezave.

Pas ceremonisë së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje menaxheri i kësaj klinike bashkë me drejtorin menaxhues mr. Msc. Armend Vokshi kanë shoqëruar

kryetarin Jasharaj, këshilltarin për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtaren Rrezarta Bahtjarin për të parë ambientet e kësaj klinike. Mysafirët janë mahnitur me ambientet shëndetësore dhe rregullin e përkushtimin e stafit këtu për të qenë sa më afër pacientëve të shumtë që ishin në ambientet e

këtij institucioni të njohur shëndetësor.

Të theksojmë në fund të këtij shkrimi se ky institucion shëndetësor gjendet në Magjistralen Prishtinë - Shkup dhe për detaje mund të informoheni në www.american-art.net, ose në tel. **038 606 116**.



Qendra Burimore në Pejë gëzon mbështetjen e SBASHK-ut **Kundër rrënimit të ndërtesës së kësaj vatre arsimore**

S B A S H K



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

institucionet lokale të Pejës dhe ato qendrore qenka marrë vendimi që të rrënohet ndërtesa e kësaj vatre arsimore me qëllim që aty të ndërtohen ambiente për një gjykatë.

SBASHK-u në reagimin publik ka kujtuar institucionet lokale të Pejës dhe ato qendrore se ndërtesa që është kthyer tani e sa vite në fole të ngrohtë për fëmijët me nevoja të veçanta, ka një historik dhe pamje të rrallë dhe është nderuar tani e 100 vite më parë dhe se është nga objektet që simbolizon Pejën nëpër dekada e vite. SBASHK-u në këtë mënyrë i është bashkuar kolegëve në Pejë dhe Shoqërisë civile në mbrojtje të këtij objekti

SBASHK-u ishte informuar nga anëtarët e vetë në Qendrën Burimore në Pejë se nga

“Institucionet lokale e qendrore le të ngritin një ndërtesë gjykatë në cilin do vend tjetër, por jo këtu e duke rrënuar këtë institucion arsimor, i cili falë përkushtuar të mësimdhënësve dhe stafit është kthyer në një ambient miqësor e të punës dhe me arritjet e mëdha në misionin e shenjtë, ka krijuar dhe gëzon respekt, jo vetëm në Kosovë, por edhe mes institucioneve simotra në Ballkan, Evropë e kudo në botë.

Institucionet lokale e qendrore në Kosovë, por edhe të gjithë ne duhet të jemi krah këtyre punëtorëve të devotshëm të arsimit dhe të ndihmojmë që të vazhdojë rrugëtimi i tyre i suksesshëm në këtë mision të shenjtë, e jo t'ua rrënojmë institucionin për të cilin kanë dhënë e kontribuar aq shumë. Pra, jo të rrënohet, por të investohet në këtë vatër të rëndësishme arsimore”, ishte reagimi publik i SBASHK-ut. Ky reagim i përbashkët i një numri kaq të madh subjektsh e shoqatash ka dhënë fryt dhe se institucionet qendrore e lokale kanë hequr dorë nga ideja për rrënimin e këtij objekti arsimor.